
Unioni i Bizneseve Shqiptare dhe Gjermane në Gjermani shpall

KONKURS

Për bursa për studente për vitin akademik 2017 - 2018

Unioni i Bizneseve Shqiptare dhe Gjermane me seli në Köln të Gjermanisë, në bashkëpunim me Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), shpallin konkursin për ndarjen e bursave për vajza / studente të vitit të 2-të dhe të 3-të në nivelin Bachelor, të Universitetit Publik të Kosovës për vitin akademik 2017 - 2018.

Në konkurs mund të paraqiten vetëm studente, pasi që Unioni i Bizneseve Shqiptare dhe Gjermane nëpërmjet këtij projekti synon të përkrahë arsimimin e vajzave / grave dhe fuqizimin e tyre.

Bursat do të dhurohen nga kompanitë shqiptare dhe gjermane anëtare të Unionit të Bizneseve.

Shuma mujore e bursës do të jete 100,00 Euro, për një periudhe 9 mujore / një vit akademik.

Kriteret që duhet të përmbushin konkurrentet janë:

1. Aplikacioni i plotësuar me fotografi
2. Të jeni shtetase e Republikës së Kosovës
3. Nota mesatare të jetë mbi 8.0
4. Situata ekonomike e familjes:
 - Nga familje pa të ardhura,
 - Nga familje me ndihma sociale, ose
 - Me të ardhura minimale
5. Të mos jeni përfituese e ndonjë burse tjetër
6. Të jeni studente e ndonjë nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës.

Në kushte të barabarta studentet që kanë anëtarë të familjes së ngushtë të vrarë apo të zhdukur në luftë (nëna, babai, vëllai, motra) dhe studentet me nevoja të veçanta, do të kenë përparësi.

Të dhënat e paraqitura duhet të jenë të sakta dhe të njëjtat do të verifikohen

Dokumentet e nevojshme që duhet t'i dorëzoni janë:

1. Aplikimi për bursë që mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Unionit të Bizneseve www.union-business.de dhe nga faqja zyrtare e OEGJK-së në Facebook www.facebook.com/oegjk
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Vërtetimi për kategorinë e studenteve nga lufta si p.sh:
 - invalid i luftës
 - fëmijë dëshmori
 - fëmijë i invalidit të luftës
 - fëmijë i veteranit të luftës, të pagjeturit/es
 - studente me nevoja të veçanta
4. Kopja e kartelës sociale - origjinali i kartelës në shikim për studentet e përzgjedhura
5. Certifikata origjinale e notave nga fakulteti për suksesin në studime
6. Kopje, faqja e parë e indeksit / ID kartelës së studentes
7. Kopja e fletëpagesës së semestrit aktual

Ju kujtojmë se aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Konkursi është i hapur nga data 30 gusht 2017 deri me datën 20 shtator 2017

Dokumentet dorëzohen në mënyrë elektronike në një dokument (PDF) në: info@oegjk.org

**Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare
Rr. Ali Hadri, pn Kati i 5, 12000 Fushë Kosovë
Republika e Kosovës**

Publikimi i rezultateve do të bëhet me datën 26.09.2017.